

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Arlind Sharani, në çështjen penale të akuzuarve: V.Q. nga , S.E. nga dhe A.D. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mosdhënia e ndihmës nga neni 191 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.699/2015 të datës 31.03.2015, pas mbajtjes së seancës kryesore publike, në praninë e prokurorit shtetit Elfete Purova, të akuzuarve, mbrojtësve të tyre avokatëve P.P. , B.N. dhe me autorizim zëvendësues avokati V.O. që të gjithë nga Prizreni dhe të dëmtuarit I.G. nga fshati ... Komuna e Prizrenit, me datë 12.06.2017 publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

V.Q. nga i ati R. dhe e ëma N. e lindur S. , i lindur me datë “i lindur me ...” në fshatin Komuna e Dragashit, tani me banim në , ka të kryer shkollën e mesme, zyrtar policor – polic në Policinë e Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, me numër personal , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

S.E. nga i ati E.dhe e ëma A. e lindur R. , i lindur më datë “i lindur me ...” në fshatin Komuna e Dragashit, tani me banim në Prizren rrugën “.....” pa nr. ka të kryer shkollën e mesme, zyrtar policor – polic në Policinë e Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, me numër personal , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

A.D. nga i ati S. dhe e ëma T. e lindur U., i lindur me datë “i lindur me ...” , në fshatin Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, zyrtar policor – polic në Policinë e Republikës së Kosovës, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, me numër personal , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

Në kuptim të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

LIROHEN NGA AKUZA

Ditën kritike me datë 11.07.2012 në orët e mbrëmjes rreth orës 20:30 minuta, në fshatin Komuna e Prizrenit, tek vendi i quajtur “...”, bashkërisht të akuzuarit nuk i ofrojnë ndihmë të lënduarit N.G. , jeta e të cilit ndodhej në rrezik të drejtpërdrejtë edhe pse këtë kanë mundur ta bëjnë pa rrezik të madh për veten apo për personin tjetër, në atë mënyrë që në momentin kur shkojnë për të mbushur ujë te burimi në vendin e quajtur “....”, pas konfliktit që kishte i lënduari me policin A.B. , i njëjti qëllohet dy herë me revole nga A.B. dhe pëson lëndime të rënda trupore, me ç’rast të akuzuarit nuk i ofrojnë ndihmë të plagosurit N.G. , jeta e të cilit ka qenë në rrezik, por largohen me një shpejtësi nga vendi i ngjarjes.

Këso dore në bashkëveprim do të kryenin veprën penale mosdhënia e ndihmës nga neni 191 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Për shkak se nuk është provuar se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale me të cilën akuzohen.

I dëmtuari I.(H.)G. nga fshati ... Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/IL.nr.669/2015 të datës 31.03.2015, kundër të akuzuarve: V. Q. nga , S.E. nga dhe A.D. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mosdhënia e ndihmës nga neni 191 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Elfete Purova mbeti në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar nën numrin PP/IL.nr.699/2015 të datës 31.03.2015, kundër të akuzuarve V.Q., S. E. dhe A.D. , për shkak se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mosdhënia e ndihmës nga neni 191 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK. Këtë qëndrim e mban prokurori i shtetit se gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancat gjatë administrimit të provave dhe atë nga deklaratat dhe dëshmitarëve V.I. , H.G. , H.S. dhe E.S. , është vërtetuar gjendja e plot dhe e drejtë faktike, me ç'rast në veprimet e akuzuarve janë formuar elementet e veprës penale me të cilën akuzohen. Andaj propozoi gjykatëse që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit V.Q. – avokati P.P. theksoj nga provat të cilat janë administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari V.Q. dhe të akuzuarit tjerë kanë kryer veprën penale mosdhënia e ndihmës nga neni 191 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK. Sipas provave që janë administruar rezulton se ngjarja kritike ka ndodhur diku rreth orës 20:30 minuta, kjo vërtetohet nga aktakuza e mëparshme e ngritur nga ana e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, kundër të akuzuarit A.B. . Ky fakt vërtetohet edhe nga raporti i policisë mbi lajmërimin sipas të cilit rezulton se ekipi i policisë së vijës kufitare, ka lajmëruar shërbimin policor për ngjarjen që ka ndodhur rreth orës 20:30 minuta, në fshatin në vendin e quajtur “....”. Mbrojtja po ashtu theksoi se menjëherë pasi që në këtë ngjarje është lënduar N.G. , në deponimet e mbrojturit të tij vërtetohet se i njëjti në atë çast ka lajmëruar edhe Qendrën Emergjente në Prizren, lidhur me këtë ka njoftuar edhe të pranishmit në vendin e ngjarjes nga të cilët ka kërkuar që të bëjnë transportin e lënduarit deri në momentin, kur do të kenë kontakt me shërbimin emergjent, pra deri në rrugën kryesore për në Prizren, sepse në vendin ku ka ndodhur ngjarja ka qenë e vështirë të orientohet shërbimi i emergjencës. Po ashtu mbrojtësi në elaborimin e tij shtoi se në deponimet e dëshmitarëve të cilët janë dëgjuar gjatë procedurës së provave – të cilët janë propozuar me aktakuzë, rezulton se të akuzuarit nuk kanë kundërshtuar ofrimin e ndihmës, por duke pasur parasysh pjesëmarrjen e shumë njerëzve në vend të ngjarjes, të akuzuarit nuk kanë mundur të kenë qasje dhe ti ndihmojnë të dëmtuarin, pasi që personat prezent e kanë futur të dëmtuarin në automjetin e tyre dhe janë nisur në drejtim të Prizrenit. Po ashtu edhe nga

deponimet e përfaqësuesit të dëmtuarit, babait të ndjerit vërtetohet se gjendja e të lënduarit në spitalin e Prizrenit, është keqësuar pas dy ditësh dhe pastaj i njëjti me kërkesën e familjarëve është transportuar jashtë vendit në Republikën e Shqipërisë dhe atë në spitalin e Tiranës, aty ka qëndruar disa ditë dhe nga spitali kanë dalë informacione se gjendja e tij shëndetësore është e mirë. Shkaku i vdekjes së lënduarit N.G., në asnjë mënyrë nuk mund të ndërlihet edhe po të kishte ekzistuar ndonjë veprim që mund të sjellë deri te bindja se të akuzuarit nuk kanë dhënë ndihmën e nevojshme. Sipas vërtetimit të Qendrës Emergjente në Prizren, rezulton se ditën kritike në ora 20:30 minuta, është pranuar thirrja telefonike nga ana e policisë dhe menjëherë është vu në veprim Qendra Emergjente në Prizren, mirëpo në ndërkohë i lënduari ka arritur në spitalin e Prizrenit. Andaj mbrojtja theksoj se duke pasur parasysh të gjitha provat e administruara konsideron se aktakuza nuk është vërtetuar dhe në këtë mënyrë i propozoi gjykatës që i akuzuari V.Q. dhe të akuzuarit tjerë të lirohen nga akuza.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit S.E. – avokati B.N. në tërësi e përkrahu fjalët e kolegut të tij dhe theksoi se aktakuza ashtu siç është paraqitur nga ana e prokurorit të shtetit, nuk përputhet me faktet të cilat janë vërtetuar gjatë procedurës së provave, por e njëjta është në kundërshtim me vetveten. Mbrojtja në këtë drejtim theksoj se në dispozitiv të aktakuzës konstatohet se këtu të akuzuarit **“kanë munduar të ndihmojnë pa rrezik për vete”** edhe pse më tej në përshkrimin faktik konstaton ekzistimin e konfliktit në vendin e ngjarjes. Gjithashtu shton se është e pa qartë përshkrimi i aktakuzës kur bëhet fjalë për veprimin e akuzuarve të ndërmarra në bashkëkryerje, pasi që në rastin konkret me përshkrimin çfarë është nuk mund të kuptohet veprimi i secilit të akuzuar veç e veç dhe më pastaj në kontekstin e bashkëkryerjes të shpjegohet si tërësi. Po ashtu mbrojtësi theksoj se konstatimi në përshkrim faktik **“të njëjtit janë larguar me një shpejtësi nga vendi i ngjarjes”** ka mbetur vetëm si konstatim nga se provat kanë treguar të kundërtën. Andaj nga të theksuarat konsideron se nuk është vërtetuar që në veprimet e të mbrojturit të tij dhe të akuzuarve tjerë të ketë çfarëdo elementi të veprës penale për të cilën janë akuzuar, andaj i propozon gjykatës që i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit A.D. – avokati V.O. e përkrahë fjalët e kolegëve të tij dhe theksoi pas administrimit të provave nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij A. D. ka ndërmarrë ndonjë veprim apo mosveprim që do të kishte elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet. Mbrojtja po ashtu theksoi se me leximin e provës materiale – raporti i Drejtorisë Rajonale e Policisë, e cila është provë shumë e rëndësishme për këtë çështje penale, është vërtetuar fakti se i akuzuari A.D., në kuadër të autorizimeve në kryerjen e detyrave të punës ka lajmëruar bazën policore si dhe Qendrën Emergjente në Prizren. Andaj duke pas parasysh të gjitha këto rrethana propozoi gjykatës që në mungesë të provave të akuzuarin A.D. ta liroj nga akuza.

Të akuzuarit në tërësi e përkrahin fjalët e mbrojtësve të tyre dhe nuk kanë pasur asgjë për të shtuar.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat e propozuara nga ana e prokurorit të shtetit dhe është bërë dëgjimi i dëmtuarit I.G., dëshmitarëve H.S., E.S., H.G., V.I., janë lexuar provat materiale: fletëparaqitja penale e ushtruar nga ana e dëmtuarit I.G. me datë 02.10.2013. Janë administruar edhe provat e propozuara nga ana e mbrojtjes dhe akuzuarit: është bërë leximi i vërtetimit të Qendrës Familjare – Shërbimi Urgjent të datës 20.04.2016, Raporti i Qendrës kryesore në mjekësinë familjare në Dragash lëshuar në emër të V.Q. lidhur me lëndimet e mara - me numër të protokollit të datës 12.07.2012, është lexuar udhëzimi për konsultim me numër , lëshuar nga QKMF në Prizren në emër të akuzuarit V.Q. të datës 11.07.2012, propozimi i përbashkët të

akuzuarve – është bërë leximi i raportit me shkrim mbi punën dhe ditarin e punës Drejtorisë Regjionale të Policisë në Prizren me nr. ... / ... - ... - ... / ... të datës 19.05.2017.

Gjykata duke e analizuar provat veç e veç dhe lidhmërinë e provave në tërësi, gjeti se nuk ka prova të cilat e arsyetojnë se në veprimet e akuzuarve V.Q., S.E. dhe A.D., formohen elementet genësore të veprës penale mosdhënia e ndihmës nga neni 191 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK. Sipas qëndrimit të gjykatës nuk është vërtetuar se të akuzuarit në ditën kritike në bashkëveprim nuk i kanë ofruar ndihmë të lënduarit N.G. , i cili si pasojë e konfliktit qëllohet me armë zjarri nga ana e policit A.B. , i cili ka pësuar lëndime të rënda trupore, me ç'rast pas situatës së krijuar të akuzuarit nuk i ofrojnë ndihmë dhe nuk e transportojnë në Qendrën Emergjente në Prizren, me qëllim të dhënies së ndihmës, por largohen me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. Andaj, pasi që nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetojë veprimet e akuzuarve që lidhen me elementet dhe figurën e veprës penale me të cilën ngarkohen, në pajtim me dispozitat e KPPK dhe ka shqiptuar aktgjykim lirues.

Gjithashtu gjatë analizës së provave dhe rrethanave të rëndësishme në rastin konkret siç janë: deklaratat e dëshmitarëve E.S. , H.G. dhe V.I. , gjykata ka vërtetuar se dëshmitarët në ditën kritike kanë qenë në vendin e ngjarjes në vendin e quajtur “....” ku të gjithë së bashku me shoqëri kishin qëndruar në atë vend dhe gjatë kësaj kohe së bashku ka qenë edhe i lënduari N. G. . Në vendin ku kanë qëndruar dëshmitarët është me burime të ujit për pije ku shërbehen qytetarët prezent, mirëpo atë ditë diku rreth orës 20:00 vjen vetura e policisë, në të cilën kanë qenë 4 zyrtarë policor, tani të tre të akuzuarit V.Q. , S.E. dhe A.D. si dhe zyrtari policor - polici A.B. i cili ka hyrë në konflikt me njërin nga personat prezent në atë vend të lënduarin N.G. . Zyrtarët policor pasi që e kishin parkuar veturën në afërsi të vendit nga vetura ka dalë polici A.B. , i cili ishte afruar rreth burimit të ujit për të mbushur një shishe me ujë, mirëpo në atë momente në mes tij dhe dëshmitarit H.G. fillon një fjalosje verbale, e cila ka eskaluar edhe ka vazhduar me përleshje në mes tyre dhe në ato momente N.G. ishte afruar policit A.B. , i cili e nxjerr revolen dhe shtënë dy herë në drejtim të N.G. , i cili me atë rast pëson lëndime të rënda trupore. Me atë rast dëshmitarët të cilët kanë qenë në shoqëri me N.G. duke parë gjendjen e tij, menjëherë kanë filluar ti japin ndihmë dhe me automjetin e tyre e cila ka qenë larg diku rreth 6 - 7 metra nga vendi i ngjarjes, e kanë transportuar për në Spitalin Regjional në Prizren. Personat prezent të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes nuk kanë kërkuar ndihmë nga të akuzuarit, po ashtu edhe të akuzuarit nuk kanë dëgjuar por edhe personat e tjera që ka qenë në vendin e ngjarjes të kenë kërkuar ndihmë prej të akuzuarve. Të gjithë dëshmitarët në deponimet e tyre kanë përshkruar momentin se si është shkaktuar plagosja e N. G. dhe po ashtu që të gjithë kanë përshkruar se ky moment ka qenë shumë i shkurt dhe befasisht, mirëpo dëshmitarët me qëllim të shpëtimit të mikut të tyre kanë vepruar me shpejtësi, me qëllim të eliminimit të pasojave të cilët do ishin fatale për të plagosurin, kështu të gjithë me disa vetura së bashku me plagosurin nisen në drejtim të Prizrenit, të cilët mbërrijnë para se të niset vetura e shërbimit urgjent.

Për më tepër në këtë drejtim, të akuzuarit edhe pse ishin larguar me veturën e tyre zyrtare nga vendi i ngjarjes së bashku me policin – dorasin A.B., i cili e kishte plagosur N.G.. Të akuzuarit duke vepruar në patrullë, respektivisht i akuzuari V.Q. edhe pse ka qenë vet i lënduar me rastin e intervenimit në konflikt me qëllim të qetësimit të situatës, ka lajmëruar bazën – Drejtorinë Rajonale të Policisë në Prizren, dhe si patrullë kanë njoftuar për ngjarjen që ka ndodhur dhe për pasojat e shkaktuara, konkretisht për plagosjen e një personi me armë zjarri i cili ka pasur nevojë për transport në Qendrën Emergjente me qëllim të dhënies së ndihmës mjekësore. Gjykata këto fakte dhe rrethana shumë të rëndësishme ka vërtetuar nga provat materiale të cilat janë administruar gjatë

procedurës së provave dhe atë nga raporti me shkrim mbi punën dhe ditarin e punës Drejtorisë Regjionale të Policisë në Prizren me numër .. / . - .. - . - .. - ... / të datës 19.05.2017. Nga kjo provë del se të akuzuarit duke vepruar në patrullë menjëherë pas ngjarjes kanë njoftuar – raportuar përmes radiolidhjes Stacionin Policor në Prizren dhe nënstation Policor në fshatin ... , duke theksuar se në ora 20:40 minuta në vendin e quajtur “....” pas një konflikti është një plagosje me armë zjarri. Në këtë kontekst, po ashtu edhe nga vërtetimi i Qendrës Familjare – Shërbimi Urgjent të datës 20.04.2016, është vërtetuar se në ditën kritike nga ana e policisë ka pasur një thirrje se në fshatin është një plagosje dhe se me atë rast pacienti – lënduari është dërguar me automjet civil për në Spitalin Regjional në Prizren – Qendrën Emergjente. Po në këtë drejtim vërtetohen edhe faktet të rëndësishme se i akuzuari V.Q. me rastin e intervenimit në përleshje si person zyrtar – policë në detyrë ka marrë lëndime trupore, i cili një kohë është kuruar në institucione mjekësore, këto fakte argumentohen me prova materiale siç janë: Raporti i Qendrës kryesore në mjekësinë familjare në Dragash lidhur me lëndimet e mara - me numër të protokollit të datës 12.07.2012, udhëzimit për konsultim me numër , lëshuar nga QKMF në Prizren të datës 11.07.2012, të gjitha këto lëshuar në emër të akuzuarit V.Q. .

Këto rrethana dhe fakte lidhur me ngjarjen që kishte ndodhur ditën kritike është vërtetuar edhe nga deklaratat e akuzuarve V.Q. , S.E. dhe A.D. , dhënë në shqyrtimin gjyqësor të cilët deponime përputhen me njëra tjetrën, ku të akuzuarit e mohojnë fakti se ditën kritike nuk i kanë ofruar ndihmë personit të plagosur N.G. . Në fakt të akuzuarit në momentin kur kanë ardhur në vendin e quajtur “....”, kanë parë një grup të personave në mesin e të cilëve ka qenë edhe N.G. , të cilët në ato momente kanë qenë në shoqëri duke u dëfryer. Mirëpo në atë rast nga vetura zyrtare e policisë ka zbritur zyrtari policor A.B., ka shkuar në burim për ta mbushur një shishe me ujë, pasi që në vendin ku kanë qenë duke shkuar si patrullë nuk ka pasur ujë për pije. Mirëpo në një moment në mes A.B. dhe grupit të personave ka filluar një fjalosje dhe me atë rast të akuzuarit duke e parë se situata ka filluar të tensionohet dhe të del jashtë kontrollit në mes të kolegut të tyre dhe grupit të personave, të njëjtit dalin nga vetura për të qetësuar situatën, por gjendja kishte eskaluar edhe më shumë ngase në atë moment N.G. ishte qëlluar me armë zjarri nga ana e kolegut të tyre A.B. dhe në një moment duke e parë këtë gjendje dhe tensionim të situatës nga ana e grupit të personave që kanë qenë prezent, të akuzuarit në një moment janë tërhequr në veturën e tyre së bashku me dorasin A.B. , dhe me atë rast menjëherë kanë lajmëruar Drejtorinë Rajonale të Policisë në Prizren, lidhur me incidentin e ndodhur dhe plagosjen si dhe Qendrën Emergjente në Prizren. Ndërsa, gjatë këtij konflikti i akuzuari V.Q. , kishte pësuar edhe lëndime trupore, gjykata këtë fakt ka vërtetuar nga provat materiale të cilat janë administruar gjatë procedurës së provave.

Përfundimisht, sipas qëndrimit të gjykatës me asnjë provë nuk është vërtetuar mosveprimi i të akuzuarve V.Q., S.E. dhe A.D., mos dhënia e ndihmës në rastin konkret personit të plagosur që do të ishte në pajtim me figurën e veprës penale e cila do të ishte plotësuar me elementin subjektiv – përgjegjësin penale të akuzuarve. Parimi bazë është paraparë ku vjen në shprehje parimi i ligjshmërisë e cila përcakton se një person është përgjegjës për veprimet e veta ose mosveprimet dhe nëse veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia, se të akuzuarit nuk i kanë ofruar ndihmë të lënduarit N.G. , me qëllim të intervenimit mjekësor për eliminimin e pasojave të shkaktuara. Pra në rastin konkret ky fakt nuk është vërtetuar sepse ajo që mund të thuhet pa mëdyshje është se të akuzuarit menjëherë pas incidentit të ndodhur e kanë njoftuar Drejtorinë Rajonale të Policisë në Prizren dhe Qendrën Emergjente të Spitalit, për plagosjen që kishte ndodhur në vendin e ngjarjes, pasi që kanë pasur obligim ligjor për lajmërimin e konfliktit që ka ndodhur në terren, derisa të njëjtit kanë vepruar në patrullë dhe për ofrimin e ndihmës për të lënduarin N. G. . Marrja dhe transportimi i personit të lënduar me veturën e policisë ku ka qenë prezent edhe zyrtari

policor A.B. i cili ka shkaktuar plagë me armë zjarri ndaj personit i cili ka qenë në konflikt me zyrtari policor, do të përbënte rrezikim të drejtpërdrejt për jetën e tyre por edhe për jetën e personave të tjerë, që kanë qenë aty prezent. Gjykata duke u nisur nga ky fakt se në vendin e ngjarjes situata ka qenë e tensionuar dhe konflikti që kishte ekzistuar në mes të grupit të personave që kanë qenë në shoqëri me të lënduarin N.G.j dhe zyrtarit policor - dorasit A.B. i cili ka shkaktuar plagë me armë zjarri, ku kanë qenë edhe të akuzuarit V.Q. , S.E. dhe A.D. duke vepruar në patrullë të cilët kanë pasur një veturë zyrtare, ka qenë e pamundur sepse nuk ka logjikë që me veturën e njëjtë ku është kryesi i veprës penale të vendoset edhe i plagosuri N.G. , do të ishte rrezik i madh me pasoja të paparashikueshme. Prandaj transportimi i personit të plagosur nga ana e shoqërisë së tij ka qenë e logjikshme dhe e arsyeshme, që në fakt të plagosurit i është dhënë ndihma e parë dhe në të njëjtin kohë është eliminuar pasoja juridike. Pra gjykata sipas analizës së provave ka ardhur në përfundim, mos dhënia e ndihmës nuk është shkaktar i pasojës fatale e cila ka ardhur disa ditë pas shkaktimit të plagëve të plagosurit N.G., i cili ka nderuar jetë në spitalin e Tiranës.

Sa i përket deponimeve të dëshmitari H.S. dhënë në shqyrtimin kryesor si person i cili ka qenë prezent në momentin kritik në vendin e ngjarjes, i cili ka deklaruar se atë ditë ka kërkuar ndihmë nga policia për transportimin e të lënduarit N.G. , por të akuzuarit V.Q. dhe A.D., i kanë thënë **“ne nuk kemi të drejtë me transportua me qu deri në Spital - ju thirrreni ndihmën e shpejt”**, të cilët pastaj janë futur në veturë dhe pasi që kanë lëshuar dritat vezulluese janë larguar me shpejtësi nga vendi. Gjykata nuk i kushtoj besimin deklaratës së dëshmitarit, pasi që me rastin e marrjes në pyetje nga gjykata nuk ka qenë bindës – ka qenë konfuz dhe në kundërshtim me provat materiale dhe atë me deklaratat e dëshmitarëve të administruara si më lart, të cilat janë plotësisht në shpërputhje me veprimin kryes të akuzuarve dhe rrethanat e krijuara në momentin kritik, të cilat prova tregojnë të kundërtën dhe nuk janë në pajtim me elementet e veprës penale të mosdhënies së ndihmës. Këtë fakt gjykata ka vërtetuar edhe nga provat materiale të cilat janë lexuar drejtpërdrejtë nga gjykata në procedurën e provave dhe atë nga raportit me shkrim mbi punën dhe ditarin e punës Drejtorisë Regjionale të Policisë në Prizren me nr. .. / . - .. - . - .. - ... / Prandaj edhe gjykata nuk i kushtoj besim kësaj prove e cila është jo objektive dhe është në kundërshtim me provat tjera të administruara në procedurën e provave.

Gjithashtu gjykata gjatë administrimit të provave ka bërë dëgjimin edhe të dëmtuarit I. G. , mirëpo gjykata nga deponimi i dëmtuarit nuk ka mundur të sigurojë asnjë fakt të rëndësishëm, që kishte ndodhur në ditën kritike që lidhet me elementet e veprës penale, për faktin se dëshmitari në ditën kur ka ndodhur rasti, nuk ka qenë prezent në vendin e ngjarjes. Por i dëmtuari si prind i të lënduar me të kuptuar lidhur me rastin ishte kthyer në Republikën e Kosovës, i cili menjëherë ka vizituar djalin e tij i cili ka qenë në kurim në Spitalin Regjional të Prizrenit. Dëmtuari I. G. gjatë vizitës së lënduarit ka shkëmbyer disa fjalë, me ç’rast i lënduari N.G. në ato momente ka qenë me vetëdije, mirëpo për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, nuk ka mundur që të bisedojë, andaj edhe gjykata vlerësoi se këto fakte nuk kanë ndihmuar në zbardhjen e çështjes, që lidhet me figurën e veprës penale – mosdhënia e ndihmës objekt i akuzës, me të cilën ngarkohen këtu të akuzuarit.

Prandaj, pas administrimit dhe analizës së provave gjykata gjatë shqyrtimit kryesor këto fakte ka vërtetuar bindshëm dhe pa asnjë dilemë dhe në mungesë të provave gjykata i lirojë të akuzuarit nga aktakuza në pajtim me dispozitën e nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.642/2015 të datës 12.06.2017

B. Profesional
Arlind Sharani

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka te drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së njëjtut, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.